VENDIM
Nr. 32, datë 26.5.2014

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“

me sekretare Blerina Basha (Çinari), në datën 5.12.2013, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh çështjen nr. 49/21 Akti, që i përket:

KËRKUES: Kudret Kopo

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Këshilli i Lartë i Drejtësisë; zyra e përmbarimit “Bailiff Service Albania”.

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm nga autoritetet e ngarkuara nga ligji.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131 shkronja “f”, 134 pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Fatmir Hoxha, shqyrtoi pretendimet e kërkuesit, i cili kërkoi pranimin e kërkesës, pretendimet e subjektit të interesuar Këshilli i Lartë i Drejtësisë, i cili kërkoi rrëzimin e kërkesës dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesi Kudret Kopo me vendimin nr. 24/2, datë 30.1.1999 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim KLD) është emëruar në detyrën e inspektorit pranë KLD-së. Me ligjin nr. 8811/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, është përcaktuar mandati 5-vjeçar i inspektorëve, me të drejtë rizgjedhjeje. Kërkuesi detyrën e inspektorit e ka vazhduar deri në datën 8.9.2008. Në këtë datë, KLD-ja ka konstatuar mbarimin e mandatit duke i ndërprerë marrëdhëniet e punës. Vendimin kërkuesi e ka ankimuar në rrugë gjyqësore.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3194, datë 21.4.2009, ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë.

3. Mbi ankimin e kërkuesit Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1280, datë 29.6.2010, ka ndryshuar vendimin nr. 3194, datë 21.4.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe duke gjykuar çështjen në fakt ka vendosur:

3.1 Pranimin e padisë;

3.2 Anulimin e pikës 8 të vendimit të KLD-së, nr. 234, datë 8.9.2008, në pjesën që bën fjalë për kërkuesin;

3.3 Anulimin e pikës 5 të vendimit nr. 227, datë 28.3.2008, të KLD-së, në pjesën që bën fjalë përkërkuesin; Detyrimin e subjektit të interesuar KLD-së, të pranojë kërkuesin që të vazhdojë detyrën e inspektorit deri në mbarimin e afatit të dytë 5-vjeçar;

3.4 Detyrimin e subjektit të interesuar, t’i paguajë kërkuesit pagën si inspektor, që nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënies së punës në datën 8.9.2008 deri në ditën e ekzekutimit të këtij vendimi.

4. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), me vendimin nr. 00-2011-997, datë 23.6.2011, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk përmbante shkaqet e parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile.

5. Në datën 14.7.2010, kërkuesi i është drejtuar Presidentit të Republikës, me cilësinë e kryetarit të KLD-së,

duke kërkuar kthimin në punë sipas vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë.

6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 2775 akti, datë 5.10.2010 ka vendosur lëshimin e urdhrit të ekzekutimit. Kërkuesi në datën 22.11.2011 i është drejtuar subjektit të interesuar, zyrës së përmbarimit "Bailiff Service Albania", për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në datën 23.11.2011, zyra e përmbarimit ka bërë lajmërimin për ekzekutimin vullnetar të vendimit. Në datën 6.12.2011, zyra e përmbarimit ka vendosur masën e sekuestros konservative në llogarinë e thesarit për efekt të detyrimit ndaj kërkuesit.

7. Dega e Thesarit, në datën 21.12.2011, ka informuar KLD-në në lidhje me vendimin e sekuestros dhe ka kërkuar që të veprohet sipas afatit të udhëzimit të Këshillit të Ministrave për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, pasi ndryshe do të ekzekutohej sekuestroja konservative dhe në datën 11.1.2012 me urdhër të brendshëm ka bllokuar fondet në llogarinë 602 të subjektit të interesuar KLD-së për ekzekutimin e vendimit. Në datën 30.5.2012, Dega e Thesarit ka hequr sekuestron konservative pasi me shkresën nr. 100, datë 24.1.2012, është njoftuar nga KLD-ja se do të fillonte likuidimi pjesor i detyrimit.

8. Në datën 27.1.2012 kërkuesit i është paguar kësti i parë i detyrimit, si pagë neto për 17 muaj, në shumën 1.615.215.00 lekë. Në datën 7.12.2012, është paguar kësti i dytë, në shumën 1.978.683.00 si pagë neto për 21 muaj. Kësti i tretë dhe i fundit si pagë neto për 6 muajt e mbetur në shumën 574.674.00 lekë është paguar në datën 12.6.2013.

9. Kërkuesi, në datën 3.9.2012, i është drejtuar përsëri Presidentit të Republikës me cilësinë e Kryetarit të KLD-së, si dhe zv/Kryetarit të këtij këshilli, duke kërkuar zbatimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë për rikthimin në punë prej KLD-së.

10. Subjekti i interesuar KLD, me shkresën nr. 1849/2.prot, datë 6.11.2012, i ka komunikuar kërkuesit se: "*...Gjykata e Apelit Tiranë, ka vendosur detyrimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë të pranojë paditësin Kudret Kopo, që të vazhdojë detyrën e inspektorit, deri në mbarimin e afatit të dytë 5-vjeçar, pra në datën 7.5.2012. Pranë KLD-së nuk është paraqitur nga ana juaj kërkesë për riemërim, para mbarimit të këtij afati. Kërkesa juaj për riemërim është paraqitur në datën 17.9.2012. Në këto kushte, KLD-ja nuk ka detyrimin ligjor për t'ju riemëruar në detyrën e inspektorit pranë inspektoratit të KLD-së.*"

II

11. ***Kërkuesi*** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese duke pretenduar cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 1280, datë 29.6.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Kërkuesi pretendon se si shkak i cenimit të së drejtës është sjellja e subjektit të interesuar KLD-së, lidhur me mosekzekutimin e detyrimit për rikthimin në punë si inspektor ose si gjyqtar apeli pa iu nënshtruar procedurave të konkurrimit, megjithëse kanë kaluar më shumë se dy vjet nga dhënia e vendimit. Gjithashtu, ai ka kërkuar pagimin e diferencave të pagave të papaguara.

12. ***Subjekti i interesuar***, Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka paraqitur prapësime duke argumentuar:

12.1 Kërkuesi nuk legjitimohet, pasi subjekti i interesuar e ka ekzekutuar detyrimin financiar që kishte ndaj kërkuesit. Lidhur me kërkesën për ta rikthyer në punë, kërkuesi nuk ka interes të ligjshëm, pasi mandati i dytë i ka përfunduar në datën 7.5.2012.

12.2 Çështja e rikthimit në detyrë si inspektor apo emërimi i tij pa konkurs si gjyqtar në një gjykatë apeli është ligjërisht e pamundur. Mandati i dytë 5-vjeçar i kërkuesit si inspektor i KLD-së, ka mbaruar në datën 7.5.2012 dhe deri në këtë datë nuk ka pasur vende vakante për inspektor. Kërkuesi nuk mund të emërohet si gjyqtar në një gjykatë apeli, pasi ai nuk ka ushtruar ndonjëherë më parë detyrën e gjyqtarit.

III

A. Për legjitimimin e kërkuesit

13. Subjekti i interesuar ka pretenduar se kërkuesi nuk legjitimohet në kërkesën për konstatimin e cenimit të parimit për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda afatit të arsyeshëm, pasi është përmbushur i gjithë detyrimi financiar i caktuar në vendimin gjyqësor, si dhe mandati i tij i dytë si inspektor ka mbaruar në datën 7.5.2012.

14. Gjykata Kushtetuese vlerëson se kërkuesi *prima facie* ka interes të ligjshëm për të kërkuar zbatimin e një vendimi gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm. Në nenet 131 shkronja "f", 134 pika 1 shkronja " g" të Kushtetutës përcaktohet e drejta e individit për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për shkeljen e së drejtës për një proces të rregullt ligjor pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

15. Gjykata Kushtetuese konstaton se në rastin konkret kërkuesi i është drejtuar gjykatave të juridiksionit të zakonshëm duke shteruar mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtës së tij. Për ekzekutimin e vendimit gjyqësor,

kërkuesi i është drejtuar subjektit të interesuar, i cili është organi kompetent për të përmbushur detyrimin e përcaktuar në vendimin gjyqësor të formës së prerë.

16. Për sa më sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kërkuesi legjitimohet për t'iu drejtuar kësaj Gjykate pasi nuk ka mjet tjetër ligjor për konstatimin e cenimit të parimit të procesit të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

B. Për pretendimin për mosekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm

17. Kërkuesi ka pretenduar se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 1280, datë 29.6.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Nga dita e marrjes së vendimit formë të prerë dhe lëshimit të urdhrit të ekzekutimit ka kaluar një kohë e gjatë, e pajustifikuar për ekzekutimin e tij.

18. Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj tashmë të konsoliduar, ka theksuar se ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i një vendimi gjyqësor të formës së prerë duhet konsideruar si pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6/1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre (*shih vendimet nr.17, datë 23.4.2013, nr. 12, datë 15.4.2011; nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 23, datë 17.5.2010; nr. 1, datë 19.1.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjykata ka theksuar se ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Pa dyshim që një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e të drejtës (*shih vendimet nr. 17, datë 23.4.2013, nr. 12, datë 15.4.2011; nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 23, datë 17.5.2010; nr. 1, datë 19.1.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Gjykata ka rikonfirmuar në disa vendime të saj qëndrimin se në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore, deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces (*shih vendimet nr. 17, datë 23.4.2013, nr. 12, datë 15.4.2011; nr. 14, datë 15.4.2010; nr. 8, datë 23.3.2010; nr. 9, datë 1.4.2009; nr. 1, datë 19.1.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Po ashtu, Gjykata, duke u bazuar edhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në mënyrë të vazhdueshme, ka rikonfirmuar se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkuesit dhe autoriteteve përkatëse. Për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara, volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (*shih vendimet nr. 17, datë 23.4.2013, nr. 12, datë 15.4.2011; nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 23, datë 17.5.2010; nr. 1, datë 19.1.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Organet shtetërore duhet të përmbushin detyrimet që rrjedhin nga një vendim gjyqësor sapo vendimi të bëhet i ekzekutueshëm. Vendimi i Gjykatës së Apelit, në përputhje me parashikimet e neneve 449 dhe 451 të KPC-së, është i formës së prerë dhe ushtrimi i rekursit ndaj tij pranë Gjykatës së Lartë nuk ka efekt pezullues, me përjashtim të rasteve kur kjo e fundit vendos pezullimin e vendimit në bazë të nenit 479 të KPC-së (*shih vendimin nr. 56, datë 21.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Gjykata çmon se çështja në shqyrtim duhet të vlerësohet lidhur me natyrën e detyrimit që duhej të ishte përmbushur nga subjekti i interesuar. Konkretisht, pagimi i pagës si inspektor gjatë kohës që kërkuesi nuk ka punuar si i tillë, për shkak të largimit nga detyra, si dhe rikthimi në detyrën e inspektorit deri në mbarimin e afatit të dytë 5-vjeçar.

24. Në rastin konkret, nuk rezulton që ekzekutimi i vendimit gjyqësor të jetë pezulluar me vendim të Gjykatës së Lartë, apo në fazën e veprimeve përmbarimore. Si i tillë, mund e duhet të ekzekutohej nga pala debitore, pa u

kushtëzuar me veprimin e kërkuesit për ekzekutimin nëpërmjet procedurave përmbarimore.

i) Kompleksiteti i çështjes

25. Në lidhje me kompleksitetin e çështjes, Gjykata vëren që çështja konkrete nuk paraqet kompleksitet nga pikëpamja faktike ose ligjore. Kërkesa në shqyrtim ka për objekt mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm, për sa i përket kthimit në punë dhe pagimit të kërkuesit për një periudhë të qëndrimit pa punë, duke filluar nga data 8.9.2008 e deri në ekzekutimin e vendimit gjyqësor.

ii) Sjellja e kërkuesit

26. Kohëzgjatja e arsyeshme e procedimit të çështjes është vlerësuar nga Gjykata si thelbësore për të përcaktuar nëse ndodhemi para rastit të tejkalimit të afateve të arsyeshme. Ky element lidhet me mosekzekutimin e vendimeve të formës së prerë për faj të veprimeve apo mosveprimeve të kërkuesit, duke sjellë tejkalimin e një afati të arsyeshëm për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

27. Në çështjen konkrete, sjellja e kërkuesit përcaktohet nga qëndrimi i tij gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit. Rezulton që kërkuesi jo vetëm nuk është bërë pengesë për realizimin e procesit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, por ai ka shfaqur interes të vazhdueshëm për ekzekutimin e tij të plotë. Mbështetur në aktet e paraqitura rezulton se kërkuesi, që në datën 27.9.2010, ka kërkuar lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të vendimit nr. 3149, datë 21.4.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i ndryshuar nga vendimi nr. 1280, datë 29.6.2010, i Gjykatës së Apelit Tiranë, duke i kërkuar subjektit të interesuar ekzekutimin e këtij vendimi. Gjithashtu, kërkuesi për ekzekutimin e vendimit i është drejtuar në mënyrë të përsëritur dhe Presidentit të Republikës. Në këtë mënyrë, sjellja e kërkuesit nuk ka shkaktuar vonesa.

iii) Sjellja e autoriteteve

28. Për sa i përket sjelljes së autoriteteve, Gjykata Kushtetuese ka theksuar se përballë detyrimit për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të gjitha subjektet, qofshin këto private apo publike, duhet të përgjigjen njëlloj (*shih vendimin nr. 7, datë 27.2.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin në shqyrtim, përmbaruesi gjyqësor privat, si subjekt procedural në fushën e ekzekutimit, ka qenë i pajisur me të gjitha mjetet procedurale që mundësojnë ekzekutimin e titullit ekzekutiv. Nga dokumentet bashkëngjitur dosjes rezulton se nga përmbaruesi gjyqësor janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme, por që kanë rezultuar të pasuksesshme për shkak të mosveprimit të debitorit, KLD-së.

29. Subjekti i interesuar është shprehur se është në pamundësi për të ekzekutuar detyrimin për të rikthyer kërkuesin në punë (referuar shkresës me nr. 1849/2 prot., datë 6.11.2012, të zv/Kryetarit të KLD-së) me argumentimin se "*... pranë KLD-së nuk është paraqitur nga ana e kërkuesit ndonjë kërkesë për riemërim, para mbarimit të datës 7.5.2012. Kërkesa e kërkuesit për riemërim është paraqitur në datën 17.9.2012. Në këto kushte, KLD-ja nuk ka detyrimin ligjor për t'ju riemëruar në detyrën e inspektorit pranë inspektoratit të KLD-së*.". Në këto kushte, subjekti i interesuar vijon t'i përmbahet qëndrimit, sipas të cilit ai është në pamundësi për të rikthyer kërkuesin në punë për shkak se nuk ka pasur kërkesë për rikthim në punë.

30. Gjykata, në jurisprudencën e saj, është shprehur se i takon debitorit të gjejë një mundësi zgjidhjeje sa më të përshtatshme për këtë rast, me qëllim vënien në vend të së drejtës së kreditorit (*shih vendimin nr. 2, datë 1.2.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar se shteti duhet të marrë përsipër vazhdimisht detyrimin për të siguruar palët pjesëmarrëse në proces se do të kenë mundësi reale të ekzekutojnë vendimin gjyqësor të formës së prerë dhe se e drejta për të pasur akses në gjykatë do të ishte iluzion, nëse sistemi ligjor ose zbatimi i tij në praktikë do të bëhej shkak që një vendim gjyqësor i formës së prerë të mbetej inefektiv dhe i pazbatueshëm për një kohë tepër të gjatë (*shih vendimet nr. 13, datë 21.3.2012; nr. 43, datë 19.12.2007, të Gjykatës Kushtetuese*). Një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (*shih vendimet nr. 13, datë 21.3.2012; nr. 8, datë 23.3.2010; nr. 6, datë 6.3.2009; nr. 43, datë 19.12.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Gjykata vëren se pretendimi i subjektit të interesuar se nuk kishte më vende vakante është i pabazuar, pasi sipas shpalljeve publike që vetë ky institucion ka bërë, rezulton se ka pasur disa vende vakante. Konkretisht, sipas vendimit nr. 268, datë 15.9.2010 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, rezulton se në mbledhje janë shqyrtuar kandidaturat për plotësimin e vendeve vakante për inspektorë pranë Inspektoratit të KLD-së, dhe pasi janë shqyrtuar propozimet e Zëvendëskryetarit është vendosur të emërohen dy inspektorë të tjerë, pa përfshirë kërkuesin. Sipas vendimit nr. 270, datë 12.11.2010 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, është vazhduar me shqyrtimin e kandidaturave për plotësimin e vendeve vakante për inspektorë dhe pas këtij shqyrtimi është vendosur të emërohet si inspektor një person tjetër i ndryshëm nga kërkuesi. Sipas vendimit nr. 282, datë 16.12.2011 të KLD-së, është riemëruar në funksionin e inspektorit pranë Inspektoratit të KLD-së një inspektor,

mandati i të cilit sapo kishte përfunduar.

32. Gjykata vëren se nuk qëndron pretendimi i subjektit të interesuar KLD, se kërkuesi nuk ka paraqitur kërkesë për rikthimin në punë. Detyrimi për kthimin në punë rrjedh nga një vendim gjyqësor. Gjithashtu kërkuesi ka paraqitur disa herë kërkesë pranë KLD-së duke kërkuar përmbushjen e këtij detyrimi.

33. Nga sa më sipër, Gjykata vëren se subjekti i interesuar, KLD-ja, ka pasur mundësinë për të ekzekutuar detyrimin ndaj kërkuesit, duke e rikthyer atë në detyrë, në zbatim të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

34. Gjykata çmon se në lidhje me pagimin e pagës, si pjesë e detyrimit të përcaktuar me vendimin gjyqësor të formës së prerë, nuk konstatohet cenim i të drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi subjekti i interesuar ka shprehur vullnet dhe ka shlyer detyrimet për këtë pjesë, megjithëse detyrimi kryesor ishte kthimi i kërkuesit në punë.

35. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nga autoritetet e ngarkuara nga ligji dhe brenda një afati të arsyeshëm është i bazuar dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja "f" dhe nenit 134, pika 1, shkronja "g" të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 dhe vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës[1].
- Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 1280, datë 29.6.2010, të Gjykatës së Apelit Tiranë, për sa i përket mos kthimit në punë të kërkuesit.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Besnik Imeraj.

Anëtarë kundër: Vladimir Kristo, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Fatos Lulo.

MENDIM PAKICE

1. Shumica, duke pranuar pjesërisht kërkesën e shtetasit Kudret Kopo, ka konstatuar cenimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 1280, datë 29.6.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë, vetëm sa i përket moskthimit në vendin e mëparshëm të punës të kërkuesit. Shumica ka konstatuar se Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD), megjithëse ka pasur vende vakante për inspektorë, nuk ka rikthyer kërkuesin në këtë detyrë, por ka emëruar persona të tjerë, duke mos përmbushur detyrimin që buronte nga vendimi gjyqësor i formës së prerë (*shih paragrafët 31 dhe 33 të vendimit*).

2. Në ndryshim nga shumica, vlerësoj se në rastin konkret, pretendimi i kërkuesit nuk është i bazuar dhe se kërkesa e tij duhej rrëzuar.

3. Gjykata, në jurisprudencën e saj, sikurse ka theksuar edhe shumica, është shprehur se i takon debitorit të gjejë një mundësi zgjidhjeje sa më të përshtatshme me qëllim vënien në vend të së drejtës së kreditorit (*shih vendimin nr. 2, datë 1.2.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë aspekt, shteti duhet të marrë përsipër vazhdimisht detyrimin për të siguruar palët pjesëmarrëse në proces se do të kenë mundësi reale të ekzekutojnë vendimin gjyqësor të formës së prerë dhe se e drejta për të pasur akses në gjykatë do të ishte iluzion, nëse sistemi ligjor ose zbatimi i tij në praktikë do të bëhej shkak që një vendim gjyqësor i formës së prerë të mbetej pa efekt dhe i pazbatueshëm (*shih vendimet nr. 13, datë 21.3.2012; nr. 43, datë 19.12.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

4. Në gjykimin tim, vlerësoj se çështje të kësaj natyre duhen shqyrtuar rast pas rasti duke evidentuar veçoritë e secilës prej tyre. Në rastin në shqyrtim, Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 1280, datë 29.6.2010, duke gjykuar çështjen në fakt, ka vendosur, ndër të tjera, detyrimin e KLD-së, të pranojë kërkuesin

[1] Kryetari z.Bashkim Dedja dhe gjyqtari z.Sokol Berberi u shprehën për pranimin tërësisht të kërkesës.

që të vazhdojë detyrën e inspektorit deri në mbarimin e afatit të dytë 5-vjeçar, si dhe t'i paguajë kërkuesit pagën si inspektor, që nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënies së punës në datën 8.9.2008 deri në ditën e ekzekutimit të vendimit (*shih paragrafin 3 të vendimit*).

5. Siç rezulton nga materialet e administruara gjatë gjykimit, KLD-ja ndonëse nuk ka pranuar që kërkuesi, sipas vendimit të gjykatës, të vazhdojë detyrën e inspektorit deri në mbarim të mandatit të dytë 5-vjeçar, i ka paguar atij pagën e plotë për të gjithë këtë periudhë. Në këto rrethana, çmoj se vendimi i gjykatës është ekzekutuar plotësisht përderisa marrëdhënia e punës është e lidhur ngushtë me pagimin e pagës dhe si e tillë nuk mund të ekzistojë në mënyrë të pavarur.

6. Në kushtet e mbarimit të mandatit të dytë dhe të shlyerjes së pagesës për këtë mandat, në këndvështrimin tim, vendimi i gjykatës duhet të konsiderohet i ekzekutuar. Si pasojë, KLD-ja nuk ka më asnjë detyrim për të përmbushur. Nëse kërkuesi pretendon të emërohet si gjyqtar apeli, duhet t'i nënshtrohet procedurave të përcaktuara nga ligji. Një qëndrim i kundërt, si në rastin në fjalë, bie ndesh me standardin e vendosur nga kjo Gjykatë, dhe njëkohësisht e bën vendimmarrjen e saj formale dhe aspak efektive.

Anëtar: Vladimir Kristo.